


FËMIJTË DHE SHKOLLA KANË NEVOJË PËR JU!

Albansk



FORELDREUTVALGET
FOR GRUNNOPPLÆRINGEN



Familja është e rëndësishme për mësimin në shkollë

Luani dhe mësoni bashkë me fëmijën Tuaj

- Përkrahja nga ana Juaj ka rëndësi më të madhe për fëmijën se për arsimtarët.
- Ju jeni ai/ajo që e njeh më së miri fëmijën Tuaj dhe dini se si mëson gjëra të reja, përdorni këtë njohuri!
- Rrini bashkë me fëmijën Tuaj kur bën detyra, edhe pse nuk kuptoni çdo gjë. Pyetni fëmijën se ç'lexon.
- Mund të folni me fëmijën mbi përjetimet në shkollë ose se ç'farë ka mësuar.
- Merrni pjesë në mbledhjet e prindërve për t'i treguar fëmijës që jeni i angazhuar në shkollën.
- Duhet të jeni shembull i mirë – tregoni që edhe Ju lexoni dhe mësoni gjëra të reja.

Jepni fëmijës Tuaj gëzimin e leximit

-fëmijë kureshtarë kanë shpesh motivacion më të madh për mësim

- Përgjigjuni pyetjeve të fëmijës, provoni të gjeni përgjigjen bashkë.
- Lavdëroni fëmijën kur ai/ajo bën pyetje dhe kur e gjen vet përgjigjen.
- Tregoni fëmijës që kureshtja është gjë e mirë duke i bërë pyetje.

www.fug.no

Ju jep një perspektivë mbi
pyetjet aktuale të politikës
shkollore

A e dini që

- legjislati i shtetit përcakton që prindërit kanë përgjegjësinë kryesore për edukimin e fëmijëve tyre, kështu kanë edhe përgjegjësi për shkollimin e fëmijëve bashkë me shkollën?
- gjithë prindërit kanë të drejtë të bashkëveprojnë me shkollën?
- mund të ndikoni mbi shkollimin e fëmijëve përmes këshillit të prindërve, si anëtar i komisionit punues të prindërve (FAU) dhe i komisionit bashkëpunues (SU), eventualisht përmes udhëheqjes së veprimtarisë?
- shkolla duhet t'i sigurojë arsimim të përshtatur secilit nxënës?
- nxënësit e shkollës fillore që nuk janë në gjendje që të vijojnë arsimimin e zakonshëm kanë të drejtë të marrin mësim në gjuhën amtare dhe mësim ekstra të norvegjishtes?
- nxënësit që nuk përfitojnë në mënyrë të mjaftueshme nga mësimet e zakonshme kanë të drejtën e arsimit special? Prindërit duhet të bëjnë lutje për këtë, me ndihmën e shkollës
- duhet t'i kushtohet rëndësi bashkëpunimit me prindërit përsa i përket ofertës së arsimit?

Jepni fjalë të reja fëmijës

- Shkoni bashkë me fëmijën në bibliotekë dhe folni mbi emrin e sendeve në gjuhën që Ju dini më së miri.
- Lexoni dhe tregoni përralla në gjuhën që Ju dini më së miri.
- Përdorni fjalë që fëmija njeh në situatë të re, jepni fjalëve kuptim të ri.

Fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme

Disa fëmijë mësojnë më mirë

- duke Ju parë që bëni të njejtën gjë
- duke parë piktura
- duke dëgjuar histori ose duke dëgjuar lexim
- duke prekur sende ose duke shkarravitur
- duke u lëvizur me tërë trupin

Si meson fëmija Juaj?

Është fort e rëndësishme që prindërit të angazhohen në mësimin e fëmijëve dhe që të marrin pjesë në konferenca me arsimtarët, në mbledhjet për prindërit dhe në aktivitete tjera të shkollës. Mjedisi mësimor përmirësohet kur prindërit i njofin arsimtarët dhe prindërit tjerë. Kur prindërit angazhohen:

- Krijohet një rrjet më i fortë dhe prindërit mund t'i japin mbështetje njëri tjetrit.
- Mund të bashkëpunojnë mbi rregulla të përbashkëta për fëmijët
- Mjedisi social në shkollën përmirësohet, do të ketë më pak ngucje ose gërgasje, më pak shamatë, do të ketë kënaqësi më të madhe.
- Fëmijët do të kenë më pak mungesa dhe do të jenë më aktivë.
- Arsimtarët do të njofin më mire çdo fëmijë dhe mund t'a përcjellin secilin më mire.
- Fëmijët do të arrijnë rezultate më të mira në lëndët.
- Një numër më i madh i nxënësve do t'a kryejë shkollën e mesme dhe do të hyjë në studime më të larta.

www.fug.no

është një shërbim nga Këshilli Prindëror për Arsimimin Bazë (shkurtimisht: FUG). Këtu mund të gjeni:

- Ide se si mund të ndihmoni mësimin e fëmijës Suaj dhe për angazhimin Tuaj në shkollën
- Lajme dhe shembuj të bashkëpunimit me shkollën
- Material dhe këshilla të dobishme për kontakte prindërore dhe me anëtarët në FAU dhe në SU.
- Faqe speciale për prindër me gjuhë minoritare
- Lidhje me faqe tjera të internetit mbi fëmijët, shkollën dhe mësimin

Foreldreutvalget for grunnsopplæringen (Këshilli Prindëror për Arsimim Bazë) (FUG) është një këshill kombëtar për prindër dhe vepron në bashkëpunim me prindër që kanë fëmijë në shkollë.

FUG interesohet:

Për bashkëpunimin në mes të shkollës dhe të familjes

- Për të mbrojtur interesin e prindërve ndaj shkollës
- Për të dhënë njohuri mbi funksionimin e bashkëpunimit në mes të shkollës dhe të familjes
- Për të dhënë njohuri se si mund t'i ndihmojnë prindërit fëmijët
- Për të vërë në rend dite dhe për të mbështetur prindërit në pyetje qëndrore si klima e brendshme, ngucje, mbledhje të prindërve, puna në shkollë, etj.

www.fug.no – një mbështetje përmes internetit për prindër me fëmijë në shkollë.